

URDHËR
Nr.36, datë 10.10.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.6, DATË 10.2.2006 TË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM “PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE DHE AUTORIZIMIT PËRKATËS”

Në bazë të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” dhe ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, me ndryshimet e pasqyruara në ligjin nr.9475, datë 9.2.2006 dhe në ligjin nr.9529, datë 11.5.2006,

URDHËROJ:

1. Urdhri nr.6 datë 10.2.2006 i Inspektorit të Përgjithshëm “Për miratimin e modelit të deklaratës së pasurisë dhe autorizimit përkatës”, të ndryshohet dhe të zëvendësohet me modelin e deklaratës sipas llojeve të deklarimit të interesave private, në zbatim të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 dhe të ligjit nr.9367, datë 10.4.2005, me ndryshimet e pasqyruara në ligjin nr.9475, datë 9.2.2006 dhe në ligjin nr.9529, datë 11.5.2006.

2. Bashkëlidhur këtij urdhri keni modelet e deklaratave të interesave private:

- Deklaratë e interesave private para fillimit të detyrës.
- Deklaratë e interesave private periodik/vjetor.
- Deklaratë e interesave private pas largimit nga funksioni.
- Deklaratë e interesave private me kërkesë.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Fatmira Laska